

2013

Aktiviteti Institucional i FSHZH-së

# RAPORT VJETOR

Programet e Investimeve

Realizimi Financiar

Projekte te reja

Auditi i Brendshëm

Monitorimi & Vlerësimi

Ndërtimi i Kapaciteteve

Komunikimi & Informimi



**FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT**  
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

**SHKURTIME**

BB	Banka Botërore
BERZH	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BEI	Banka Europiane e Investimeve
CEB	Banka e Këshillit të Europës
CES	Consulting Engineers Salzgitter
DPUK	Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjiellës Kanalizimeve
FIDIC	Federata Ndërkombëtare e Konsulencës Inxhinierike (International Federation of Consulting Engineers)
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
GoA	Qeveria Shqiptare
IDA	Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim
IDB	Banka Islamike e Investimeve
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
MIS	Sistemi Menaxhimit të Informacionit
NTA	Norway Trust Account
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
OFID	Fondi i OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar
PNMZM	Plani i Ndjekjes së Masave Zbutëse mbi Mjedisin
PZHL	Plani i Zhvillimit Lokal
RI	Roughton International
SIF	Fondi i Investimeve Sociale
WBIF	Kuadri i Investimeve për Ballkanin Perëndimor (Western Balkans Investment Framework)

## Pasqyra e lëndës

1. PËRMBLEDHJE .....	4
2. Programi “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore e Lokale në Shqipëri” .....	7
3. Programet e Furnizimit me Ujë të Zonave Rurale .....	14
3.1 “Furnizimi me Ujë I Zonave Rurale I & II” .....	14
3.2 “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale” , SIF IV .....	15
3.3 “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III” , .....	15
3.4 Aktivitete të planifikuara për vitin 2014 për programet e furnizimit me ujë të zonave rurale: .....	16
3.5 Bashkëpunimi i FSHZH me Komitetin e Zhvillimit të Rajoneve në kuadër të Projekteve të Infrastrukturës Vendore .....	17
4. AKTIVITETI INSTITUCIONAL .....	18
4.1 Menaxhimi Financiar .....	18
4.2 Komunikimi dhe Informimi .....	24
4.3 Monitorimi dhe Vlerësimi .....	25
4.4 Auditimi i brendshëm .....	26
4.5 Misione të Donatorëve .....	28
5. AKTIVITETE TE TJERA .....	29
5.1 Përgatitja dhe aplikimi për projekte të reja .....	29
5.2 Projekte të bashkëfinancuara nga Bashkimi Europian në kuadër të Programit IPA .....	29
5.2.1 IPA 2012 – Përmirësimi i aksesit në shërbimet publike për grupet vulnerable në zonat periferike në qytetet Tiranë dhe Durrës .....	29
5.2.2 IPA 2013 – Përmirësimi i rrugëve dhe sistemit të furnizimit me ujë në zonat rurale .....	29
5.2.3 IPATECH - Teknologji në miniaturë: sinergjia e kërkimeve dhe risive për të përmirësuar zhvillimin ekonomik të Adriatikut .....	29
5.2.4 Projekti MONTEAL .....	30
5.2.5 Projekti HERA .....	30
5.3 Programi i Investimeve Kapitale në Bregdetin e Jugut .....	31
5.4 Ndërtimi i kapaciteteve të NJQV-ve .....	31
6. ANEKSE .....	33
6.1 Informacion mbi nënprojektet e programit “Rrugët Dytësore & Lokale”, financuar nga Banka Botërore & GoA (IDA) .....	34
6.2 Informacion mbi nënprojektet e programit “Rrugët Dytësore & Lokale”, financuar nga OFID .....	35
6.3 Informacion mbi nënprojektet e programit “Rrugët Dytësore & Lokale”, financuar nga CEB .....	37
6.5 Informacion mbi nënprojektet e programit “Rrugët Dytësore & Lokale”, financuar nga IDB (Dhjetor 2013) .....	40
6.6 Informacion mbi nënprojektet e programit “Rrugët Dytësore & Lokale”, financuar nga EBRD, EIB, .....	41
6.7 Informacion mbi nënprojektet e programit “Rrugët Dytësore & Lokale”, financuar nga KfW, IPA 2009 .....	45
(Dhjetor 2013) .....	45
6.8 Informacion mbi nën-projektet e programit “Furnizimi me Ujë i zonave Rurale”, financuar nga KfW (Dhjetor 2013) .....	46
6.9 Realizimi i zërave të buxhetit për vitin 2013 (sipas Donatorëve) .....	47
6.10 Shpenzimet sipas Donatorëve dhe Kategorive për vitin 2013 (në Euro) .....	50
6.11 Rrugët Dytësore dhe Lokale të përfunduara deri më 31 Dhjetor 2013 .....	51
5.13 Projekte në zbatim dhjetor 2013 .....	82
5.14 Harta treguese e nënprojekteve të përfunduara dhe në zbatim nga FSHZH deri më 31 dhjetor 2013 .....	104

## 1. PËRMBLEDHJE

Fondi Shqiptar i Zhvillimit gjatë këtij viti është angazhuar intensivisht në përbushjen e misionit të tij për nxitjen e një zhvillimi ekonomik dhe social të qëndrueshëm, në nivel rajonal dhe lokal.

Sfidat e këtij viti, kanë rikonfirmuar profesionalizmin e FSHZH-së dhe kapacitetet e saj për të menaxhuar projekte shumëdimensionale, si dhe për të lëvruar në kohë dhe me cilësi produkte që përmirësojnë gjendjen ekonomike dhe sociale të shqiptarëve.

Menaxhimi financiar gjatë vitit 2013 ka garantuar ekuilibrat financiarë duke mbajtur aktivitetin ekonomik-financiar të organizuar brenda limiteve të lejuara të financimit. Gjithashtu vëmendje i është kushtuar administrimit dhe menaxhimit të fondeve me përgjegjshmëri dhe transparencë, si dhe monitorimit e mbikqyrjes së detajuar të fondeve sipas komponentëve përkatës: investime në infrastrukturë, administrim të brendshëm, asistencë teknike, etj.

Gjatë këtij viti, FSHZH ka arritur një realizim financiar në vlerën 83 milionë USD ose në masën 91% kundrejt buxhetit të parashikuar.

Investimet në infrastrukturë edhe këtë vit zënë peshën kryesore të aktivitetit institucional të FSHZH-së.

Gjatë kësaj periudhe, FSHZH është angazhuar në një total prej 191 nënprojektesh të infrastrukturës rurale, me një shpërndarje gjeografike gjithëpërfshirëse.

Në kuadër të Programit “**Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale**”, deri më 31 dhjetor 2013, FSHZH ka financuar rikonstruksionin e 138 segmenteve rrugore dytësore & lokale dhe urave, me një gjatësi totale prej rreth 1140 km.

**Programi “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale”**, ka përfunduar punimet infrastrukturore për 29 skema ujësjellësish. Në fund të vitit 2013, rezulton se punimet civile për ndërtimin e ujësjellësive kanë përfunduar në 9 kontrata që përfaqësojnë 29 skema ujësjellësash, duke mundësuar kështu furnizimin me ujë të pijshëm dhe higjienikisht të pastër për 51 fshatra në qarqet Dibër, Kukës dhe Shkodër.

Paralelisht me punën për zbatimin e projekteve të investimeve, stafi i FSHZH-së është angazhuar edhe me vlerësimin e nevojave për ndërhyrje dhe përgatitjen e projekteve të reja, aplikimin pranë donatorëve dhe sigurimin e fondeve për financim. Gjatë vitit 2013 u përgatitën dhe u dorëzuan 4 projekte ndërkufitare (IPA), nga të cilat janë fituar 3 projekte; 2 prej tyre kanë filluar të zbatohen. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar gjithashtu këtë vit edhe përgatitjes së programeve të reja të investimeve, me fokus në zhvillimin urban dhe turistik, në funksion të programit dhe strategjive të reja qeverisëse. Një aktivitet i rëndësishëm i zhvilluar në këtë kuadër ishte edhe puna e kryer për hartimin e Programit të Investimeve Kapitale të Bregdetit të Jugut, në bashkëpunim me Qeverinë Shqiptare, NJQV-të, dhe deputetët e Qarkut Vlorë.

Zhvillimi rajonal dhe ngritja e kapaciteteve lokale është një tjetër aktivitet i rëndësishëm i FSHZH-së gjatë këtij viti. Përmes Departamentit të Zhvillimit Rajonal, një strukturë



tashmë e konsoliduar pranë FSHZH, janë organizuar një seri takimesh dhe trajnimesh të cilat kanë kontribuar jo vetëm në ngritjen e kapaciteteve lokale por edhe në harmonizimin e prioriteve kombëtare me nevojat rajonale e lokale, dhe rritjen e efikasitetit të qeverisjes vendore në marrëdhënie me qeverinë dhe donatorët. Në këtë kuadër janë organizuar 5 kurse trajnimi mbi Planifikimin dhe Menaxhimin e projekteve, ku morën pjesë 110 persona, staf i NJQV-ve. Njëkohësisht ka vijuar puna për trajnimin e stafit të NJQV-ve lidhur me funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve dhe ujësjellësave.

Gjatë këtij viti, ka vijuar realizimi me sukses i një fushate për informimin publik përmes mediave vizive dhe atyre të shkruara, nëpërmjet së cilës është siguruar dhe njohja e gjerë e publikut me rezultatet e punës së FSHZH-së si dhe aktivitetet në vijim.

## Paraqitja e nënprojekteve sipas donatorëve dhe statusit të tyre dhjetor 2013

Donatori	Totali	Projektenë fazën e përgatitjes së dokumentacionit	Në tenderim / vlerësim	Në kontraktim	Në zbatim	Projekte të përfunduara Në Garanci	Mbyllur Përfundimisht në dhjetor 2013
KfW (RWS)	30				1	29	
KfW (SIF IV) Water Component	15	15					
IDA GOA (SLRP)	9					5	4
OFID I & II (SLRP)	22		3	2	3	4	10
CEB (SLRP)	32					13	19
IPA 2008 (SLRP)	4						4
IDB – ISTISNA (SLRP)	15	2			4	6	3
EBRD, EIB & IPA 2010-2011(SLRP)	55				33	17	5
KfW & IPA 2009 (SLRP)	9	3	4		2		
<b>TOTALI</b>	<b>191</b>	<b>20</b>	<b>7</b>	<b>2</b>	<b>43</b>	<b>74</b>	<b>45</b>

## 2. Programi “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore e Lokale në Shqipëri”


Programi “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”, bashkëfinancuar nga Banka Botërore, Qeveria Shqiptare dhe Donatorë të tjerë në vlerën 368 milionë USD, synon të rrisë përpjekjet konkrete për përmirësimin e infrastrukturës në vend si dhe për rritjen e aksesit ndaj shërbimeve bazë dhe tregjeve, veçanërisht në zonat rurale nëpërmjet rehabilitimit të rrjetit rrugor dytësor dhe lokal.

Programi, deri në dhjetor 2013, është financuar në shumën rreth 368 milionë USD dhe ka avancuar në të gjithë komponentët e tij.

Donatori	Financimi (milionë)
<sup>1</sup> BB	20 USD
OFID (OPEC) I & II	25 USD
GoA	9 USD
CEB	40 EUR
NTA	0.18 EUR
IPA 2008	8 EUR
BERZH	50 EUR
BEI	50 EUR
IDB/ ISTISNA	40 USD
KfW	15 EUR
IPA 2009	8.8 EUR
IPA 2010	20 EUR
IPA 2011	14.5 EUR
WBIF	4 EUR
DEVOLL HYDRO POWER	0.76 EUR
<sup>2</sup> Total (milionë USD)	<b>367.62 USD</b>

Deri më 31 dhjetor 2013, FSHZH ka financuar rikonstruksionin e 138 segmenteve rrugore dytësore & lokale dhe urave, me një gjatësi totale prej rreth 1140 km.

Nga këto deri në fund të muajit dhjetor 2013, janë përfunduar 87 segmente rrugore, me një gjatësi prej 708 km, dhe vijon puna për zbatimin e punimeve civile në 42 rrugë me një gjatësi prej 386 km. Në proces tenderimi/vlerësimi janë 9 segmente rrugore me një gjatësi totale prej 46 km. Njëkohësisht janë financuar edhe 3



<sup>1</sup> Në marrëveshje financimi është 12.2 milionë SDR

<sup>2</sup> Kursi mesatar i këmbimit për periudhën 2008 – 2013 Eur/USD = 1.30

kontrata të rritjes dhe përmirësimit të sigurisë rrugore, të cilat kanë përfunduar punimet. Ndërkohë janë në fazën e përgatitjes së dokumentacionit teknik 45 segmente të tjera rrugore në të gjithë vendin.

### **Ecuria e deritanishme e projektit**

Komponentët kryesorë të projektit dhe ecuria e secilit prej tyre janë si më poshtë:

**Komponenti i parë:** Financimi i aktiviteteve mbështetëse të programit:

Financimi i aktiviteteve mbështetëse të Programit “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale” është komponenti i parë i cili në thelb të tij ka një sërë procesesh kyçe dhe mjaft të rëndësishme për mbarëvajtjen e programit. Inventarizimi i rrjetit rrugor dytësor dhe lokal, hartimi i projekteve teknike, zbatimi i procedurave transparente të prokurimit, supervizimi dhe konsulenca e specializuar ndërkombëtare, aplikimi i procedurave mjedisore gjatë zbatimit të punimeve, funksionim – mirëmbajtja dhe ngritja e kapaciteteve kanë qenë disa nga proceset kyçe që kanë kontribuar në zbatimin me sukses të këtij programi.

### **Inventarizimi rrjetit rrugor dytësor dhe lokal**

Ky komponent përfshin përgatitjen e bazës së të dhënave për rrugët rurale si dhe përgatitjen e dokumentacionit të prokurimeve për fazën e implementimit.

Nga një total prej 9800 km rrugë dytësore dhe lokale, ka përfunduar inventarizimi i plotë me të dhëna të detajuara për rreth 4127 km, të identifikuar si rrugë kryesore të rrjetit rrugor rural. Për çdo segment rrugor, i cili është pjesë e këtij inventari, janë mbledhur të dhëna të hollësishme, si popullsia, trafiku, gjendja (ashpërsia e rrugës), aksesit që krijon si edhe varfëria në zonë. Është bërë një analizë shumëkriterëshe për secilin nga këto seksione, e përbërë nga disa komponentë. Vetëm gjatë vitit 2013 kësaj analize i janë shtuar edhe 53 segmente të reja rrugore. Paralelisht me zhvillimin e këtij procesi, vijon puna për përditësimin e të dhënave ekzistuese në inventar, duke i rifreskuar me të dhënat aktuale të rrugëve të rikonstruara, ose në proces rehabilitimi.

### **Hartimi i projekteve teknike**

Përsa i përket hartimit të projekteve teknike, që financohen në kuadër të këtij programi, janë projektuar 1200 km rrugë. Për këtë proces janë kontraktuar disa kompani të cilat kanë përgatitur dhe dorëzuar projektet teknike, përgatitjen e dokumentave të prokurimit dhe instrumentave mbrojtës shoqëruar. Për të gjitha projektet janë plotësuar dosjet me projektin, preventivin dhe gjithë dokumentacionin përkatës.

Një pjesë e segmenteve rrugore kanë pasur projekte teknike të hartuara nga NJQV-të përkatëse. Këto projekte janë kontrolluar dhe rishikuar nga Njësia e Mbështetjes Teknike pranë FSHZH-së dhe janë dërguar për ripunim në rastet kur ka qenë e nevojshme. Për periudhën janar – dhjetor 2013, janë kontrolluar dhe ripunuar 88 projekte teknike.

### **Prokurimi**

Procedurat e prokurimit për punimet civile në këtë program janë kryer në përputhje me Udhëzuesit e Bankës Botërore “Guidelines: Procurement Under IBRD Loans and IDA Credits Procurement”. Rrugët e financuara nga BERZH dhe BEI janë prokuruar në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në Marrëveshjen e Financimit të Projektit për Rrugët Dytësore dhe Lokale dhe Udhëzuesit e Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, publikuar në janar të 1992 dhe rishikuar në maj të 2010. Rrugët e financuara nga Banka Botërore, GoA, OFID, dhe CEB, janë tenderuar sipas metodës “tender i hapur ndërkombëtar”. Ndërkohë prokurimi i punimeve civile për rrugët e financuara nga IDB, po kryhet sipas metodës “tender i hapur kombëtar”. Rrugët e financuara nga KfW dhe IPA 2009 tenderohen sipas metodës “tender i hapur ndërkombëtar”. Gjatë periudhës janar - dhjetor 2013, janë shpallur për tenderim ose tenderuar 26 segmente rrugore.

### **Supervizimi i kontratave të punimeve civile**

Kompania Louis Berger SAS e cila ka qenë e kontraktuar për supervizionin e punimeve civile, ka përfunduar kontratën e shërbimeve në fund të muajit janar 2013. Kompania JV IRD& Eptisia ka filluar shërbimet e konsulencës së supervizionit të rrugëve lokale dhe dytësore për një periudhë katërvjeçare deri në fund të vitit 2016.

### **Procedurat mjedisore**

Në kuadrin e Programit “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”, një vëmendje e veçantë i është kushtuar ndjekjes së procedurave mjedisore siç parashikohen në Manualin e Procedurave, në kërkesat e programit dhe marrëveshjet me donatorët.

### **Funksionim – Mirëmbajtja dhe Ngritja e Kapaciteteve**

Funksionimi dhe mirëmbajtja e rrugëve të financuara është një nga elementet thelbësore të cilit i është kushtuar një vëmendje e veçantë. Për këtë është punuar në dy drejtime kryesore:

- Për rrugët dytësore është bashkëpunuar me ARRSH-në, për marrjen në dorëzim të rrugëve të përfunduara dhe vijimin e funksionim – mirëmbajtjes;
- Për rrugët lokale është bashkëpunuar me të gjithë NJQV-të përfituese ose jo nga programi për të ngritur kapacitetet lokale lidhur me funksionim – mirëmbajtjen e rrugëve lokale;

FSHZH ka kryer transferimin e 33 rrugëve pranë ARRSH së bashku me rrugët dhe programin e planifikimit të mirëmbajtjes së rrugëve ROMAPS. Në të përfshihet informacioni për të gjitha rrugët e marra në dorëzim nga ARRSH. Pranë ARRSH-së, pas përfundimit do të kalojnë edhe rrugët që janë duke e rindërtuar. Gjatë vitit 2013 është punuar për realizimin e procedurës për marrjen në dorëzim nga ana e Autoritetit Rrugor Shqiptar të Sistemit të Menaxhimit të Aseteve të Rrugëve Sekondare/Rajonale, sistem i cili do të lejojë që ARRSH të kryejë planifikimin dhe buxhetimin e mirëmbajtjes së tyre.


Në lidhje me ngritjen e kapaciteteve të NJQV-ve përfituese për funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të reja, vijon trajnimi i tyre nga stafi i FSHZH-së. Përmes tij janë trajnuar 373 komuna e bashki si dhe përfaqësues të Qarqeve, me një total prej rreth 740 personash. Gjatë kësaj periudhe, ka përfunduar cikli i dytë i trajnimeve në të gjitha Qarqet e Shqipërisë.

Aktualisht, FSHZH është në fazën e përzgjedhjes së një kompanie konsulente, e cila në bashkëpunim me stafin teknik të FSHZH, do të marrë përsipër ngritjen në një stad të ri të kapaciteteve të stafit të NJQV-ve për mirëmbajtjen e rrugëve të komunave.

**Komponenti i dytë** – Financimi i punimeve civile për përmirësimin e rrugëve prioritare rajonale dhe lokale.


### Rrugët e financuara nga Banka Botërore dhe Qeveria Shqiptare

Banka Botërore ka financuar përmes IDA-s, Programin “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale” me 20 milionë USD<sup>3</sup>. Këtij investimi i është shtuar dhe një financim prej 5 milionë USD nga Qeveria Shqiptare. Deri më 31 dhjetor 2013 me fonde të Bankës Botërore dhe Qeverisë Shqiptare janë financuar 6 projekte për akse rajonale të rëndësishme rrugore në një gjatësi prej 50 km. Në fund të muajit dhjetor 2013, rezulton se kanë përfunduar punimet në 6 segmente rrugore me një gjatësi totale prej 50 km, të financuar nga ky donator, në Qarqet Kukës, Dibër, Fier, Durrës dhe Tiranë. Ndërkohë si rezultat e menaxhimit të mirë të fondeve nga ky donator, gjatë këtij viti janë financuar 3 kontrata shtesë që kryesisht kanë të bëjnë me sinjalistikën dhe sigurinë rrugore, sistemim skarpatash, vendosje e parrakeve metalikë si dhe punime ndriçimi. Punimet për këto 3 kontrata shtesë kanë përfunduar. Duhet theksuar fakti që pjesa e financimit të BB dhe OFID I, u mbyll në qershor 2013, sipas parashikimeve në marrëveshjen e financimit. Në fund të këtij procesi, në raportin e përfundimtar të hartuar nga Banka Botërore, PRRDL vlerësohet në nivelin “Highly Satisfactory”, ose shumë i kënaqshëm.



### Rrugët e financuara nga OFID I & II

Fondi i OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID) ka financuar programin në dy faza në një total prej 25 milionë USD. Deri në fund të muajit dhjetor 2013 nga ky donator janë financuar 17 segmente rrugore dhe 5 ura, në një gjatësi totale prej 114.12 km. Nga këto 12 segmente rrugore dhe 2 ura ose 97.7 km kanë përfunduar punimet civile. Rrugët e përfunduara gjenden në Qarqet Berat, Durrës, Elbasan, Gjirokastrë, Korçë, Lezhë, Shkodër, dhe Vlorë. Kanë përfunduar gjithashtu punimet për rikonstruksionin e urës së Baldushkut dhe urës së re të Velabishtit.




3 Në marrëveshje financimi është 12.2 milione SDR

Grafiku iu referohet segmenteve rrugore të cilat kanë përfunduar punimet civile dhe atyre që janë në proces zbatimi. Ndërkohë vijojnë punimet në 3 segmente rrugore të financuara nga OFID II në një gjatësi prej 16.41 km. Janë në proces kontraktimi 2 segmente të reja rrugore në komunën e Dajtit dhe bashkinë e Sarandës si dhe 3 ura historike në bashkitë e Beratit dhe Lezhës. Gjithsejt nga ky donator janë financuar 115.4 km rrugë dhe ura.

### Rrugët e financuara nga Banka e Këshillit të Europës (CEB)

Banka e Këshillit të Europës (CEB) ka financuar Programin “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale” me 40 milionë Euro. Me këto fonde deri në fund të muajit dhjetor 2013 janë financuar 32 segmente rrugore me një gjatësi totale prej 249 km. Punimet civile kanë përfunduar në të gjitha rrugët e financuara nga ky donator. Grafiku iu referohet 32 segmenteve të financuara deri në dhjetor 2013 nga Banka e Këshillit të Europës.


Rrugët e përfunduara janë vënë në funksionim të plotë. 13 segmente rrugore janë ende në periudhë garancie dhe mbikqyren për një periudhë 1 vjeçare nga supervizori dhe stafi teknik i FSHZH duke garantuar cilësinë e punimeve dhe qëndrueshmërinë e rrugëve. Ndërkohë 19 segmente rrugore kanë përfunduar periudhën e garancisë dhe janë mbyllur përfundimisht duke iu dorëzuar Autoritetit Rrugor Shqiptar ose NJQV-ve përkatëse.



### Rrugët e financuara nga Banka Islamike për Zhvillim dhe Qeveria Shqiptare (IDB & GoA)

Banka Islamike për Zhvillim ka financuar Programin “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore & Lokale” në shumën prej 40 milionë USD. Këtij financimi i është shtuar dhe një kontribut i Qeverisë Shqiptare në vlerën 4 milionë USD.


Deri në dhjetor 2013, janë financuar 13 segmente rrugore ose 101 km. Nga këto kanë përfunduar punimet civile për 9 segmente rrugore në një gjatësi prej 82.4 km. Në proces zbatimi janë 4 segmente rrugore me një gjatësi prej 18.7 km. Kanë përfunduar punimet në akset rrugore: Kam – Golaj, Ura e Mesit – Prekal, Ura Gjader – Mnelë, Fshat i Ri – Kukël, Sheshi i trageteve – Lekbibaj, Kukës – Shishtavec Lot 2 dhe Ura Dushaj – Sheshi i Trageteve, Sopot – Kërnajë dhe Tropojë – Bucaj. Punimet vijojnë në segmentet: Rruga Nacionale – Dajç, Ura Shulbatër – Gurrë e Vogël Lot 1, Kodër Marlekaj dhe Peshkopi – Ushtelenxë.





## Rrugët e financuara nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), Banka Europiane e Investimeve (EIB), IPA 2010 - 2011


EBRD, EIB, IPA 2010, IPA 2011 kanë financuar këtë program me 138.5 milionë Euro. Në marrëveshjen e financimit është vendosur që fondet e këtyre donatorëve të menaxhohen si një financim i vetëm. Deri në dhjetor 2013 me këto fonde janë financuar 55 segmente rrugore në një gjatësi prej 516 km. Deri në dhjetor 2013 kanë përfunduar punimet në 22 akse rrugore me një gjatësi prej 195 km. Vijojnë punimet në 33 segmente rrugore me një gjatësi prej 321 km.



Ecuria e përgjithshme e gjithë projekteve ka qenë pozitive dhe mund të thuhet se standardet e reja të aplikuara në këtë projekt po japin rezultate të mira në lidhje me cilësinë e punimeve.

## Financimi i KfW dhe IPA 2009

KfW dhe IPA 2009 kanë financuar këtë program përkatësisht me 15 dhe 8.8 milionë Euro. Në marrëveshjen e financimit është vendosur që fondet e këtyre donatorëve të menaxhohen si një i vetëm. Me këto fonde parashikohet financimi i rreth 80 km rrugë në Qarqet Kukës, Dibër dhe Shkodër. Aktualisht kanë përfunduar projektet teknike për të gjitha segmentet rrugore të parashikuara për financim, dhe procesi i konsultimit me publikun. Ndërkohë janë tenderuar 2 segmente rrugore “Ruga Nacionale – Qelëz” dhe “Ruga Nacionale – Iballë”, në rrethin e Pukës, Qarku Shkodër, të cilat janë në proces zbatimi dhe kanë filluar punimet civile në terren. Në proces kontraktimi janë edhe 4 segmente të tjera me një gjatësi prej 43.7 km në Qarqet e Kukësit dhe Shkodrës. Në kuadër të këtij financimi, ka përfunduar projekti teknik si dhe është kryer konsultimi me publikun edhe për segmentin Tamarë- Vermosh me gjatësi 29.1 km.





**Konkluzione:**

Projekti ka paraqitur një performancë shumë të kënaqshme në të gjithë komponentët e tij.

FSHZH si agjenci implementuese e këtij programi po vazhdon të kryejë me sukses rolin e saj në monitorimin, koordinimin dhe implementimin e shpejtë të tij, duke garantuar realizimin me cilësi dhe përgjegjshmëri të të gjitha objektivave të zbatimit të programit.

Viti 2013 shënoi financimin e rreth 1140 km rrugë dytësore dhe lokale në të gjithë vendin, duke plotësuar që këtë vit objektivat dhe pritshmëritë e programit.

Ecuria e financimit ka treguar progres dhe rezulton që deri në fund të vitit 2013 janë në proces zbatimi 368 milionë USD.

Performanca shumë e mirë e këtij programi është vlerësuar edhe nga institucionet financiare ndërkombëtare, të cilat përmes misionëve dhe raporteve të ndryshme e kanë vlerësuar maksimalisht atë.

Në raportin përfundimtar të hartuar nga Banka Botërore, PRRDL vlerësohet në nivelin "Highly Satisfactory", ose shumë i kënaqshëm.

### 3. Programet e Furnizimit me Ujë të Zonave Rurale

Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale është një program i bashkëfinancuar nga Qeveria Shqiptare, Banka Gjermane për Zhvillim, KfW, dhe Bashkimi Europian. I ndarë në disa projekte të veçanta ky program përbën një nga iniciativat më serioze të këtyre viteve të fundit për të përmirësuar furnizimin me ujë të pijshëm të zonave rurale. Ky program ka arritur deri më sot një financim total prej 52.66 milionë Euro. Përmes këtyre programeve parashikohet të përfitojnë më shumë se 180,000 banorë në zonat rurale, duke mundur kështu furnizimin me ujë të pijshëm dhe higjienikisht të pastër.


Programi	Kohë zgjatja	Financimi Euro (milion)	Qarqet ku implementohet	Popullsia që shërbehet me ujë (banore)	Nr. i fshatrave
<b>RWSP I &amp; II</b>	2008-2014	11.66	Kukes, Diber, Shkoder	40,000	53
<b>SIF IV</b>	2010-2016	5.8	Kukes, Diber, Shkoder	20,000	23
<b>RWSP III</b>	2014-2018	35.2	Qarqe ne gjithë Shqiperine	120,000	Per tu percaktuar

#### 3.1 “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale I & II”

Programi “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale”, financuar nga KfW, konsiston në ndërtimin e 30 skemave të ujësjellësave rurale në 54 fshatra në Qarqet Dibër, Shkodër dhe Kukës, duke kontribuar në përmirësimin e jetesës së rreth 40.000 banorëve. Programi ka një kohëzgjatje 6 vjeçare dhe përfundon në fund të vitit 2014. Vlera e programit është 11.66 milionë Euro (7.5 milionë + 1.5 milionë) për masat investuese, 1 milionë Euro Grant për ngritje kapacitetesh, masat shoqëruese, dhe 1.66 milionë Euro kontribut i Qeverise Shqiptare & përfituesve të drejtpërdrejtë).

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2013, programi ka zhvilluar një aktivitet intensiv për zbatimin e punimeve civile në 30 skema ujësjellësash të financuar, por edhe për ngritjen e kapaciteve lokale lidhur me funksionim – mirëmbajtjen, administrimin e ujësjellësave, si dhe monitorimin dhe raportimin e performancës së Njësive të Furnizimit me Ujë të ngritura brenda komunave.

Në fund të vitit 2013, rezulton se punimet civile për ndërtimin e ujësjellësave kanë



përfunduar në 9 kontrata që përfaqësojnë 29 skema ujësjellësash, duke mundësuar kështu furnizimin me ujë të pijshëm dhe higjienikisht të paster, për 51 fshatra në qarqet Dibër, Kukës dhe Shkodër.

Ndërkohë punimet vijojnë pjesërisht me riparime defektesh dhe punime të vogla për mbylljen e objekteve dhe dorëzimin përfundimtar të tyre. Për një skemë tjetër pritet financimi nga DPUK për linjën kryesore dhe është planifikuar që zbatimi i punimeve të kryhet gjatë programit SIF IV. Parashikohet që muaji mars 2014, të shënojë përfundimin e punimeve civile edhe për skemat e mbetura.

Me fondin rezervë të programit, janë hartuar fizibilitetet për ndërtimin e ujësjellësave të 5 fshatrave në komunat Postribë dhe Tropojë e Vjetër, në qarqet Shkodër dhe Kukës. Punimet kanë përfunduar edhe për këto skema ujësjellësash.

### **3.2 “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale” , SIF IV**

Në kuadër të programit SIF IV, financuar nga KfW në vlerën 5 milionë Euro dhe 0.8 milionë Euro të tjera që janë kontribut lokal nga NJQV-të përfituese synohet ndërtimi i 15 skemave të ujësjellësave në Qarqet, Kukës, Shkodër dhe Dibër çka do të sigurojë furnizim të pjesshëm me ujë higjienikisht të pastër rreth 20,000 banorë në zonat rurale. Gjatë këtij viti, shënohet progres në programin e ri SIF IV. Ka përfunduar hartimi i fizibiliteteve dhe së bashku me donatorin në bazë të kriterëve përzgjedhëse, është kompletuar lista finale për financim. Kjo listë përmban 15 skema ujësjellësash të cilat përfshijnë 23 fshatra dhe janë përqëndruar në 11 komuna. Janë përgatitur Marrëveshjet Paraprake të Investimit me komunat përfituese, dhe u janë shpjeguar procedurat për pagesën e kontributit lokal. Aktualisht është mbledhur rreth 21 përqind e kontributit të këtyre skemave.

Janë dorëzuar draft-projektet për 15 skema të cilat janë verifikuar dhe shoqëruar me komentet përkatëse nga NJPH dhe Njësia e Mbeshtetjes Teknike dhe synohet që brenda muajit janar 2014 të dorëzohen edhe projektet finale. Ndërkohë është shpallur tenderi parakualifikues ku firmat kanë paraqitur dokumentat për kualifikimin paraprak për këto 15 skema. Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2014 synohet të lidhen kontratat e zbatimit të projekteve për këto 15 rrjete ujësjellësash në Qarqet Dibër, Kukës, Shkodër.

### **3.3 “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III” ,**

Objektivi specifik i këtij projekti të pjesshëm është të përmirësojë kushtet e jetesës të banorëve në zonat rurale dhe të mbështesë zhvillimin ekonomik të këtyre zonave. E gjithë kjo do të mundësohet nëpërmjet ndërhyrjeve në shkallë të mesme dhe të vogël në ndërtimin e sistemeve të furnizimit me ujë. Financues të këtij programi do të jenë KfW me 25.4 milionë Euro dhe Bashkimi Europian përmes IPA 2013, me 9.8 milionë Euro.

Projekti është parashikuar të zgjasë nga 2014 deri në 2019. Pjesa e financimit për ndërtimin e rrugëve do të përfundojë në vitin 2016 kurse pjesa e ndërhyrjes në ndërtimin e ujësjellësave ruralë do të vazhdojë deri në 2019.

Njëkohësisht në vijim të hartimit dhe zbatimit të programeve për ujësjellësë, është siguruar një financim nga WBIF në shumën 750,000 Euro, të cilat do të përdoren për hartimin e fizibiliteteve teknike dhe sociale në kuadër të Programit të Ujësjellësave Rurale III, i cili parashikohet të ketë shtrirje në të gjithë vendin.

### **3.4 Aktivitete të planifikuara për vitin 2014 për programet e furnizimit me ujë të zonave rurale:**

Në vijim të punës për realizimin me sukses të projektit, gjatë vitit 2014, parashikohen një sërë aktivitetesh të rëndësishme. Disa nga aktivitetet e parashikuara për këtë periudhë kohore janë :

- Përfundimi i punimeve për 100% të nënprojekteve si dhe riparimi i defekteve per RWS I & II;
- Vazhdimi i trajnimit të stafit të komunave për funksionimin dhe mirëmbajtjen e skemave të ujësjellësave sipas Programit të Trajnimit;
- Vazhdimi i trajnimit të stafit të komunave mbi procedurat tregtare & financiare, dhe funksionim -mirëmbajtjen sipas Programit të Trajnimit;
- Monitorimi i aktiviteteve të Funksionimit të Ujësllësave;
- Takime pune (Workshop) me komunat për procedurat e raportimit dhe fazave të punës;
- Bashkëpunim dhe mbështetje për komunat e PUR për organizimin e Shërbimit të Furnizimit me Ujë në nivel komune;
- Formalizimi dhe ngritja e njësive për të gjitha komunat përfituese;
- Bashkëpunim dhe mbështetje për Komunat në procedurat e aplikimit për Liçencë si Operatorë të Shpërndarjes së Ujit dhe për aprovimin e tarifave të ujit;
- Aprovimi i projekteve finale sipas listës së aprovuar të programit SIF IV;
- Takime informimi dhe orientimi me Grupet e Përfituesve të Ujit, për të gjitha skemat e ujësjellësave të aprovuara në program;
- Lidhja e marrëveshjes finale për investim, plotësimi i kontributit lokal në masën 100 %;
- Shpallja e kompanisë fituese për implementim, lidhja e kontratës së zbatimit me firmën fituese si dhe fillimi i punimeve.
- Për sa i përket programit të tretë Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale, parashikohet të nisët procedura për mbledhjen dhe krijimin e bazës së të dhënave, përgatitja e short listes, takimet në Komuna si dhe kryerja e studimeve të fizibiliteteve teknike.

#### **Prokurimi**

Gjatë vitit 2011, janë shpallur tenderat për punimet civile të 26 skemave të ujësjellësave të financuar në kuadër të këtij programi, dhe janë përzgjedhur fituesit për 10 lotet. Procedurat e prokurimit për punimet civile u kryen sipas metodës “tender i hapur kombëtar”. Për skemat shtesë në Sopot dhe Postribë, janë bërë shtesa kontrate për 4 kompani ekzistuese. Këto shtesa janë bërë duke respektuar përqindjet që lejon kontrata për kompanitë që ofertuan. Gjatë vitit 2013 në vazhdim, u shpall tenderi për 15 skemat e përzgjedhura për investim sipas programit SIF IV sipas procedurave përkatëse.

## Procedurat mjedisore

Në kuadër të zbatimit të procedurave për mbrojtjen e mjedisit të programit “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale”, janë kryer këto aktivitete:

- Janë hartuar fizibilitetet mjedisore dhe Planet e Menaxhimit të Mjedisit për të gjitha skemat e ujësjellësve.
- Janë duke u ndjekur procedurat mjedisore dhe përgatitja e lejeve mjedisore për skemat e reja që u futen me fondet e Programit SIF IV.
- Gjatë vitit 2013, krahas përgatitjes së fizibiliteteve teknike dhe projekteve për skemat e përzgjedhura, kanë vijuar procedurat mjedisore për plotësimin me leje mjedisore si dhe lejen nga drejtoria e baseneve për përdorimin e burimeve ujore.

## Konkluzione:

Programi RWS I është në fazën e përfundimit të punimeve infrastrukturore për 30 skema ujësjellësish. Një pjesë e kontratave e mbyllën periudhën e garancisë së defekteve në fund të vitit 2013 dhe një pjesë tjetër parashikohet ta mbyllin këtë periudhë në vitin 2014. Ecuria e projektit si në zbatimin e punimeve ashtu edhe në zbatimin e masave shoqëruese shfaqet e kënaqshme. Menaxhimi profesional dhe zbatimi i kënaqshëm i këtij programi, ka rezultuar me përfitimin e një financimi të dytë nga ana e KfW-së përmes Programit SIF IV, në vlerën prej 5.8 milionë Euro. Njëkohësisht në vijim të hartimit dhe zbatimit të programeve për ujësjellësia, është siguruar një financim nga WBIF në shumën 750,000 Euro, të cilat do të përdoren për hartimin e fizibiliteteve teknike dhe sociale në kuadër të Programit të Ujësjellësive Rurale III, i cili parashikohet të ketë shtrirje në të gjithë vendin. Financues të këtij programi do të jenë KfW me 25.4 milionë Euro dhe Bashkimi Europian përmes IPA 20013, me 9.8 milionë Euro.

### 3.5 Bashkëpunimi i FSHZH me Komitetin e Zhvillimit të Rajoneve në kuadër të Projekteve të Infrastrukturës Vendore

Gjatë vitit 2013, FSHZH është angazhuar për vlerësimin teknik të projekteve të infrastrukturës lokale, në ndihmë të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

Bazuar në buxhetin e shtetit të vitit 2013, për financimin e projekteve të reja të infrastrukturës rrugore, nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve u miratua financimi i 53 segmenteve rrugore të shpërndara në të gjitha Qarqet e Shqipërisë me vlerë rreth 2.2 miliardë lekë.

Gjatë këtij viti është ndjekur ecuria tekniko – financiare e objekteve të miratuar në vitin 2011, 2012 dhe 2013 si dhe është kryer procesi i vlerësimit të gjithë objekteve në zbatim që financohen nga Buxheti i Shtetit nëpërmjet Fondit për Zhvillimin e Rajoneve.

Rregjistrimi i kërkesave të NJQV-ve, vlerësimi teknik, social - ekonomik si dhe raportimi i informacionit nga FSHZH, është kryer me shumë profesionalizëm dhe transparencë.

## 4. AKTIVITETI INSTITUCIONAL

### 4.1 Menaxhimi Financiar

Analiza financiare për vitin 2013, bazuar në sistemin raportues të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, jep informacion kryesisht mbi funksionet kryesore financiare: planifikimin, kontabilitetin, menaxhimin financiar të investimeve dhe atë operativ-administrativ.

Gjatë këtij viti, janë bërë përpjekje për ruajtjen dhe garantimin e ekuilibrave financiarë të institucionit në mënyrë që i gjithë aktiviteti ekonomik - financiar i tij të jetë i organizuar brenda limiteve të lejuara të financimit. Gjithashtu vëmendje i është kushtuar administrimit dhe menaxhimit të fondeve me përgjegjshmëri dhe transparencë, si dhe monitorimit dhe mbikqyrjes së detajuar të fondeve sipas komponentëve përkatës: investime në infrastrukturë, administrim të brendshëm, asistencë teknike, etj.

Gjatë vitit 2013, FSHZH ka arritur një realizim financiar në vlerën 83 milionë USD ose në masën 91% kundrejt buxhetit vjetor.

Në kuadër të Projektit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale dhe Projektit të Ujësllësave Rural është ndjekur zbatimi i punimeve dhe i periudhës së garancisë si dhe janë financuar 121 kontrata punimesh civile, kryesisht rrugë dhe ujësllësa, me vlerë rreth 76 milionë USD. Për realizimin buxhetor janë ndjekur me përpikmëri plani i punës dhe procedurat e përcaktuara në marrëveshjet e nënshkruara me donatorët si dhe legjislacioni shqiptar.

Pasqyrat financiare, që paraqiten më poshtë, përmbajnë të dhëna progresive të cilat krijojnë një skenar të qartë të mjedisit ekonomik - financiar dhe të performancës së aktivitetit të FSHZH-së gjatë kësaj viti, si dhe një analizë në nivelin strukturor të shpenzimeve dhe të të ardhurave duke paraqitur në këtë mënyrë raportin si dhe peshën specifike të kategorive dhe komponentëve të veçantë.

### Të ardhurat e FSHZH-së

Gjatë këtij viti, FSHZH ka menaxhuar fondet e akorduara nga donatorët e huaj dhe Qeveria Shqiptare në kuadër të 3 Programeve në zbatim.

Aktualisht FSHZH ka në ndjekje financiare këto programe:

- Programi “Rrugët Dytësore dhe Lokale” – financuar Banka Botërore, OFID,CEB,IDB, ISTISNA, EIB, EBRD, KFW & IPA 2009 dhe Qeveria Shqiptare ;
- Programi “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale – financuar nga KFW, Qeveria Shqiptare dhe përfituesit e drejtpërdrejtë;
- Programi IPATECH projekti ndërkuftar IPA Adriatik “Teknologji në miniaturë: sinergjia e kërkimeve dhe risive për të përmirësuar zhvillimin ekonomik të Adriatikut”
- Kontributi i komunave (përfituesit) në masën 10 % të vlerës së investimit si bashkëfinancim në projektet në zbatim që zbatojnë këtë kriter.

## **Disbursimi i Fondeve gjatë vitit 2013 sipas Programeve**

Gjatë këtij viti , në përputhje me kërkesat për financime, janë disbursuar nga donatorët e huaj rreth 59.54 Milionë USD sipas Programeve si më poshtë:

- Për Programin e Rrugëve Dytësore dhe Lokale gjatë këtij viti janë disbursuar rreth 56.94 milionë USD nga të cilat IDA 1.38 milionë USD, OPEC 2.50 milionë USD, IDB & ISTISNA 8 milionë USD, KFW SIF IV & IPA 2009 2.89 milionë USD, CEB 3.37 milionë USD, BEI (EIB) Kredi & Grant 27.80 milionë USD, BERZH (EBRD) 11 milionë USD.
- Për Programin “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale” KFW IV janë disbursuar 2.55 milionë USD.
- Pr Programin IPATECH projekti ndërkufitar IPA Adriatik janë disbursuar 57 mijë USD.

Fondet e akorduara nga Qeveria Shqiptare për vitin 2013 për të gjitha projektet e reja dhe në vazhdim në komponentët Investime, Kosto Lokale dhe TVSH janë në vlerën 15.12 milionë USD.

## **Të ardhura të tjera**


Gjatë aktivitetit ekonomiko-financiar të saj, FShZh realizon hyrje të vlerave monetare (të ardhura) në vlera të pakta nga aktivitetet dytësore si: shitje të dokumentave të tenderave, investime të likujditeteve në Lekë (vendosje depozite me afat), të ardhura për shërbime të kryera nga institucioni si seleksionimi i projekteve për Grantet Konkurruese, sekuestrim i garancive bankare etj.

Gjatë këtij viti janë vendosur depozita me afat mujor, 3 mujor dhe 6 mujor për fondet në lekë përkohësisht të lira duke u ndjekur procedurat e përcaktuara në Vendimin e Këshillit Teknik - Administrativ për përzgjedhjen e ofertës më të mirë ofruar nga Bankat të cilat operojnë sot në treg. Vlera e të ardhurave të përfituara gjatë këtij viti është 211 mijë USD, nga shitja e dokumentave për tender, interesat e depozitave me afat dhe garancite bankare.

Gjithashtu gjatë këtij viti në kuadër të Projektit të “Furnizimit Rural me Ujë” janë arkëtuar direkt nga përfituesit rreth 28 mijë USD si kontribut i tyre në bashkëfinancimin e nënprojekteve.

### Shpenzimet dhe Realizimi i Zërave të Buxhetit për vitin 2013

Gjatë këtij viti FSHZH ka menaxhuar një fond prej 83 milionë USD, me një realizim financiar në masën 91% të buxhetit vjetor 2013. Realizimi financiar paraqitet më poshtë i ndarë sipas komponentëve.



### Infrastruktura

Ky zë përbën aktivitetin kryesor të Institucionit dhe përfaqëson investimet në infrastrukturë kryesisht për rrugë dhe ujësjellësa. Si komponent është realizuar në një vlerë prej rreth 75.66 milionë USD ose në masën prej 91% kundrejt buxhetit vjetor. Në fakt realizimi fizik i këtij komponenti është në vlerën 80,25 milionë USD ose 96% e buxhetit vjetor, pasi në dhjetor 2013 janë dërguar për disbursim tek donatorët rreth 3.2 milionë Euro të cilat pritet të financohen në janar 2014.

(Tabela bashkëngjitur “Realizimi i zërave të Buxhetit për periudhën janar - dhjetor 2013”).

### Realizimi financiar për periudhën janar - dhjetor 2013 për kategorinë “Investime”

Programet	Realizimi në % kundrejt realizimit vjetor 2013	Realizimi në vlerë (shprehur në USD)
Investime Qeveria Shqiptare+TVSH	17.68 %	13,379,872
Përfituesit+Fondet e FSHZH	1.10 %	831,836
IPA Adriatica	0 %	0
Rrugët Dytësore dhe Lokale (IDA, CEB, OPEC, EIB & EBRD, ISTISNA)	79.08 %	59,831,050
Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale (KfW)	2.14 %	1,621,430
<b>Totali</b>	<b>100 %</b>	<b>75,664,188</b>



## **Projektim - Supervizimi**

Ky zë është realizuar në vlerën 4.15 milionë USD ose në një masë prej 100 % kundrejt Buxhetit vjetor 2013.

Në këtë komponent në kuadër të Projektit të Rrugëve Dytësore & Lokale janë përfshirë rreth 657 mijë USD shpenzime për kontratën e supervizionit me kompaninë Louis Berger, rreth 995 mijë USD për kontratën e projektimit me kompaninë JV AIC Progetti & Sphaera financuar nga EIB Kredi/Grant, rreth 1.92 milionë USD shpenzime për kontratën e re të supervizionit me kompaninë IRD Engineering financuar nga EIB dhe KfW SIF IV, rreth 142 mijë USD për kontratën e projektimit me kompaninë Ingenuity Consulting Engineers financuar nga IDB si dhe në kuadër të Projektit të Furnizimit me Ujë të Zonave Rurale – KfW janë përfshirë rreth 436 mijë USD shpenzime për kontratën e projektim-supervizionit dhe asistencës teknike me kompaninë KOCKS dhe kontratat e konsulentëve lokale.

Në këtë zë përfshihen të gjitha likujdimet e kryera në favor të kontraktorëve për projektimin e objekteve të reja si dhe për supervizionin e objekteve që janë në zbatim dhe në përfundim të punimeve.

## **Asistenca Teknike**

Ky komponent është realizuar në vlerën 909 mijë USD ose në masën 82% kundrejt Buxhetit vjetor dhe përfshin konsulencë të huaj në kuadër të Projektit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale në vlerën 72 mijë USD si dhe në kuadër të Projektit të Furnizimit me Ujë të Zonave Rurale – KfW rreth 617 mijë USD, si dhe 220 mijë USD në kuadër të mbështetjes institucionale dhe informimi & komunikimit.

## **Kualifikime**

Ky komponent përfshin shpenzimet e bëra për kualifikimin e stafit të FSHZH-së dhe të komunave dhe bashkive në përputhje me buxhetin e aprovuar. Ky zë është realizuar në vlerën 99 mijë USD ose në masën 29 % kundrejt buxhetit vjetor . Në këtë kategori janë përfshirë shpenzimet për kualifikime me temë “Zhvillimi ekonomik lokal” për stafet e komunave dhe bashkive si dhe aktivitete dhe trajnime të stafit sipas temave dhe Departamenteve respektive (procedurat e prokurimeve, audit, analiza financiare dhe kontabilitet,procedurat e FIDIC).

## **Pajisje**

Kjo kategori është realizuar në vlerën 402 mijë USD ose në masën 94 % kundrejt buxhetit vjetor. Në këtë zë janë përfshirë pagesat për blerje mobiljesh dhe pajisje kompjuterike, investime rrjeti, pajisje inxhinierike dhe pajisje mbrojtëse për rrugët në kuadër të Projektit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale.

## **Shpenzime operative**

Shpenzimet operative gjatë vitit 2013 janë realizuar në vlerën 191 milionë Lekë ose rreth 91% kundrejt buxhetit vjetor 2013.

Realizimi i zërave të shpenzimeve të nënkomponentëve të kësaj kategorie kundrejt buxhetit vjetor janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

**Realizimi i shpenzimeve operative kundrejt buxhetit vjetor 2013.**  
**Analiza e shpenzimeve të kostos operative**

<b>REALIZIMI KUNDREJT BUXHETIT 2013 (Kosto operacionale) Lekë</b>				
<b>Nr.</b>	<b>ZERAT</b>	<b>BUXHET 2013</b>	<b>REALIZIMI 2013</b>	<b>PERQINDJA E REALIZIMIT</b>
1	Kanceleri	3,000,000	2,382,689	79.42
2	Karburant	10,850,000	10,823,000	99.75
3	Servis makinash/siguracion	6,550,000	6,456,557	98.57
4	Pagat	158,406,000	146,712,850	92.62
5	Dieta	5,750,000	3,535,840	61.49
6	Telefon dhe PT	3,676,000	3,467,948	97.55
7	Internet	1,500,000	1,182,719	78.85
8	Energji Elektrike/Uje	2,410,000	1,575,000	65.35
9	Zyra me qera	1,820,000	1,776,247	97.54
10	Mirembajtje/Sigurim godine	3,900,000	3,016,832	77.35
11	Te tjera/Petty cash	5,820,000	5,777,471	99.27
12	Publikimi & Promovime	4,170,000	3,128,026	96.07
13	Shpenzime gjyqesore	200,000	2,000	1.00
14	Kontrata Sherbimi	790,000	639,490	80.95
15	Servis kompjuter dhe fotokopje	750,000	409,415	55
	<b>TOTAL</b>	<b>209,592,000</b>	<b>190,886,084</b>	<b>91 %</b>

**a. Shpenzimet për kancelari**

Gjatë këtij viti shpenzimet për kancelari janë realizuar në vlerën prej 2.38 milionë Lekë ose 79.42 % kundrejt buxhetit vjetor. Shpenzimet kryesore në këtë zë janë kryesisht për kancelari të ndryshme, letër, bojra për fotokopje dhe printera, etj., të cilat janë shpenzuar sipas nevojave.

**b. Shpenzimet për karburant**

Buxheti vjetor për këtë zë të shpenzimeve është 10.85 milionë Lekë, ose 4.67% të buxhetit vjetor të kostos operative. Gjatë këtij viti shpenzimi i kryer është në vlerën 10.82 milionë Lekë dhe perfaqeson shpenzime për blerje karburanti në mbështetje të mbikqyrjes në terren të punimeve, kryesisht për departamentin e infrastrukturës.

**c. Shpenzimet për mirëmbajtjen dhe siguracion të automjeteve**

Këto shpenzime përfshijnë shërbimet periodike, shërbimet e veçanta, blerjen e pjesëve të këmbimit, gomave dhe siguracionin e mjeteve. Buxheti i parashikuar për këtë zë është rreth 6.55 milionë Lekë. Realizimi për këtë vit është rreth 6.45 milionë Lekë ose 98.57 % kundrejt buxhetit vjetor.

#### d. Shpenzimet për paga, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore

Shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore për vitin 2013 janë parashikuar në shumën 158 milionë Lekë. Ky zë është realizuar në masën 92.62 % kundrejt buxhetit vjetor.

#### e. Shpenzimet për dieta e shërbime

Shpenzimet për dieta dhe shërbime për vitin 2013 janë parashikuar në shumën 5.75 milionë Lekë. Ky zë shpenzimesh është realizuar në vlerën 3.53 milionë Lekë ose 61.49 % kundrejt buxhetit vjetor dhe mbështet kryesisht aktivitetin e kryer nga Departamenti i Infrastrukturës për mbikqyrjen e objekteve në terren. Realizimi në këtë masë vjen si rezultat i aplikimit të paketës së re të trajtimit financiar të punonjësve që shkojnë me shërbim jashtë qendrës së punës.

#### f. Shpenzimet e komunikimit

Në këtë zë përfshihen shpenzimet për komunikim si dhe shpenzimet e shërbimit postar. Ky zë është parashikuar 3.67 milionë Lekë dhe është realizuar në vlerën 3.46 milionë Lekë ose 94.34% kundrejt Buxhetit vjetor.

#### g. Shpenzime të tjera

Në zërin shpenzime të tjera përfshihen shërbim interneti, facilitete dhe qera rajonale të FSHZH-së, energji elektrike, ujë, servis kompjuteri dhe fotokopje, ruajtje e godinës, mirëmbajtje e sistemeve të zyrave qendrore, siguracione, seminare të stafit, blerje të vogla etj. Për këtë zë në Buxhetin 2013 janë parashikuar rreth 16.2 milionë Lekë nga të cilat rreth 6 milionë Lekë janë financuar nga fondet e veta. Ky zë është realizuar në vlerën 13.8 milionë Lekë ose 85.20 % kundrejt buxhetit vjetor.

#### h. Publikime & Promovime

Në këtë zë përfshihen shpenzimet për analizat periodike të stafit, dizajne, printime, publikime dhe njoftime të ndryshme në shtyp (njoftime për tendera, punësime, etj). Ky zë është realizuar në vlerën 3.12 miliona leke ose në masën 96% kundrejt buxhetit vjetor.

#### i. Kontrata shërbimi dhe shpenzime gjyqësore

Në këtë zë përfshihen shpenzime gjyqësore dhe asistencë juridike si dhe pagesa për kontrata shërbimi. Për këtë zë në buxhetin 2013 janë parashikuar rreth 990 mijë Lekë dhe realizimi është në masën 641 mijë Lekë.

## 4.2 Komunikimi dhe Informimi

Komunikimi dhe Informimi është një aspekt mjaft i rëndësishëm i punës së Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Arritjet e deritanishme të FSHZH-së, dhe veçanërisht intensiteti i lartë i projekteve dhe investimeve për këtë periudhë nëpërmjet një strategjie komunikimi të mirëpërcaktuar i janë komunikuar një publiku më të gjerë.

Gjatë vitit 2013, ka vazhduar aktiviteti për informim publik, në funksion të paraqitjes së rezultateve të arritura si për sa i përket volumit të madh të punimeve ashtu edhe për buxhetin e realizuar. Si rezultat i strategjisë së komunikimit të aplikuar gjatë vitit 2013, është konstatuar një impakt i lartë, rritje dhe forcim i imazhit të institucionit, njohje e gjerë publike, që është përkthyer në një rritje të mbështetjes publike, shtim të frekuencave dhe të kanaleve të komunikimit me përfituesit, dhe lehtësimin e aktivitetit të FSHZH-së në terren.

Informimi i publikut është realizuar në këto drejtime:

- Mediat vizive

Aktiviteti i FSHZH ka qenë prezent në median vizive me një frekuencë minimalisht prej 3 kronikash në javë me një total prej më shumë se 50 kronikash të transmetuara e të mbuluara në nivel kombëtar me tre mediat kryesore kombëtare, në edicionet e lajmeve si edhe në rreth 10 televizione lokale me audiencë të lartë. Gjithashtu është krijuar një rrjet i gjerë kontaktesh me gazetarë të televizioneve kombëtare dhe lokale. Ndër televizionet të cilat kanë transmetuar aktivitetin e FSHZH, mund të përmendim: TVSH, Top Channel, Klan TV, ABC News, Ora News, Albanian Screen, UTV, etj.

Në kuadër të 20 vjetorit të FSHZH-së, si dhe në zbatim të planit të vizibilitetit të SLRP, të parashikuar në komponentin e PVP-së të Grand CEB SLR, u transmetua në TV publik dhe ato kombëtare një spot televiziv. Nëpërmjet transmetimit të këtij spoti u arrit të pasqyrohej përmes imazheve dhe mesazheve përfaqesuese, impakti dhe arritjet e investimeve të kryera nga FSHZH në kuadër të projektit të rrugëve dytësore dhe lokale, duke ja përçuar këtë informacion një audience të gjerë. Gjithashtu speciale për aktivitetin e FSHZH ka patur nga Top-Channel, TV Klan, TV Channel One etj.

- Shtypi i shkruar

Përveç mbulimit televiziv të aktivitetit, paralelisht është bërë dhe pasqyrimi i aktivitetit të FSHZH-së në shtypin e shkruar. Çdo dalje në terren është pasqyruar dhe në të përditshmet kryesore në Shqipëri si: gazeta “Shqiptarja.com”, Gazeta Shqiptare, Gazeta “Panorama”, “Gazeta Shqiptare”, “Standard”, “Koha Jonë”, “Gazeta 55”, etj. Gjithashtu është kushtuar një vëmendje e veçantë nga media e shkruar punës së FSHZH-së. Disa artikuj të rubrikës “Speciale” me intervista, janë përgatitur në revista, gazeta, si dhe media elektronike si: Gazeta Koha Jonë, Gazeta Panorama, Gazeta Telegraf etj.

- Faqja zyrtare e web-it

I gjithë aktiviteti në kuadër të informimit të publikut është pasqyruar me detaje e imazhe në faqen zyrtare të web-it të FSHZH në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Gjithashtu ka vijuar publikimi në faqen e internetit i të gjitha lajmeve, njoftimeve dhe prokurimeve të cilat janë zhvilluar gjatë kësaj periudhe, si edhe ka pasur një ndërveprim aktiv në faqen e

internetit përse i përket aktiviteteve të zhvilluara në kuadër të Programit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale dhe programeve të tjera.

- Faqja zyrtare e Facebook-ut

I gjithë aktiviteti i FSHZH në kuadër të informimit të publikut është pasqyruar me detaje e imazhe e video dhe në faqen zyrtare të Facebookut. Në këtë faqe e cila u hap per here te pare gjate ketij viti, përveç publikimeve të aktiviteteve të FSHZH është bërë një komunikim interaktiv i personave të interesuar jo vetëm me postime në murin e kësaj faqeje, por dhe me komente të ndryshme të investimeve të kryera si dhe atyre të reja.

Gjatë muajit dhjetor 2013, u përgatitën dhe u shpërndanë materialet informuese të fundvitit. Në këtë kuadër u dizenuan dhe printuan kartolina dhe kalendarë muri me logon e FSHZH-së të cilat iu shpërndanë Institucioneve të ndryshme partnere dhe të gjitha Njësive të Qeverisjes Vendore.

### 4.3 Monitorimi dhe Vlerësimi

Gjatë vitit 2013, ka vijuar puna për monitorimin e ecurisë së programeve kryesore në zbatim nga FSHZH.

Monitorimi i ecurisë së Programit të Rrugëve Dytësore & Lokale në të gjithë elementet e tij, ka qenë një ndër aktivitetet parësore të sektorit të Monitorim – Vlerësimit. Puna për monitorimin e programit ka konsistuar në marrjen dhe vlerësimin e të dhënave mbi ecurinë e nënprojekteve për të gjitha fazat e investimit dhe të gjithë Donatorët.

Janë shqyrtuar të gjitha raportet mujore periodike të hartuara nga supervizori, dhe është bërë monitorimi i indikatorëve të ecurisë së projektit, duke përfshirë avancimin teknik dhe atë financiar.

Në kuadër të monitorimit të këtij programi, janë përgatitur raporte të monitorimit të programit. Me kërkesë të donatorëve që kanë financuar këtë program janë dërguar informacione që lidhen me ecurinë e programit dhe indikatorët e performancës.

Është hartuar raporti përfundimtar për financimet e PRDL nga Banka Botërore dhe OFID I. Në kuadër të përfundimit të këtij financimi është asistuar Banka Botërore për hartimin e raportit përfundimtar *Implementation Completion Report (ICR)*, i cili ka vlerësuar këtë program si shumë të suksesshëm.

Në fund të këtij viti, vërehet një performancë shumë e mirë e programit në të gjithë elementët e tij.

**Monitorimi i Programit “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale”** ka ndjekur treguesit periodikë të komponenteve kryesorë të tij duke i krahasuar me planet e punës, dhe ka vërejtur përgjithësisht një ecuri të mirë të këtij programi. Gjatë kësaj periudhe puna është fokusuar në monitorimin e indikatorëve bazë të programit, deri në këtë fazë të zbatimit të tij. Pas fillimit të punimeve civile në terren, janë shqyrtuar me kujdes raportet e supervizorëve për të gjitha skemat e financuara dhe konstatohet se faza e zbatimit të punimeve civile paraqet performancë pozitive.

#### 4.4 Auditimi i brendshëm

Raporti vjetor i aktivitetit të Auditimit të Brendshëm të FSHZH bazohet në Standardet Ndërkombëtare për praktikën profesionale të AB, të miratuar nga IIA, dhe në Manualin e Procedurave të FSHZH, sek 5.1, pika 311/e.

Raporti komunikon rezultatet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm gjatë vitit 2013, përçon problemet më të rëndësishme të identifikuara dhe të trajtuara, ecurinë drejt përmirësimeve të vazhdueshme dhe veprimeve korrigjuese, si dhe jep informacion mbi risqet e vlerësuara në çështjet e kontrollit dhe menaxhimit të projekt/programave.

Gjatë vitit 2013, NJAB ka zbatuar planin e auditimit për vitin 2013, të miratuar në KD, në masën 116.7%. Janë realizuar 7 misione auditimi, si dhe 2 shërbime konsulence, ku një analizë dhe vlerësim situatë i kërkuar nga Drejtori Ekzekutiv (DE) si dhe 5 raportime mbi zbatimin e rekomandimeve nga 4 të parashikuara.

Janë përfshirë në proces auditimi: *rreth 73.48 milion \$ të kontraktuar dhe 31.84 milion \$ të paguara në të dy programet (PRDL dhe PUR), janë testuar dhe verifikuar në terren 26 nënprojekte, 157.43 km rrugë, 118.99 km projekte teknike dhe janë përfshirë në auditim të gjitha strukturat menaxhuese të FSHZH.*

Nga misionet e ushtruara është konstatuar se:

- Sistemi i menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm siguron efikasitet dhe efektivitet në arritjen e objektivave, njëkohësisht garanton fleksibilitetin e duhur në plotësimin e kërkesave dhe kriterëve të donatorëve të ndryshëm duke krijuar mundësitë për absorbimin e projekteve alternative.
- Sistemi i menaxhimit të projekt/programave siguron monitorim të plotë të tyre në çdo fazë të ciklit të projektit, konstatimin e dobësive dhe mangësive dhe vetëkorrigjimin e shpejtë të tyre gjatë fazës së zbatimit.
- Sistemi i raportimit financiar dhe menaxherial siguron nxjerrjen e raportimeve të shpejta dhe të sakta dhe në përputhje me kriteret e donatorëve, qeverisë shqiptarëve apo grupeve të interesit. Sistemi i raportimit realizon raportime si për çdo projekt/program në zbatim ashtu edhe të integruar në kuadër të FSHZH. Raportimet financiare të FSHZH çertifikohen çdo vit nga kompani ndërkombëtare të auditimit.
- Është vendosur dhe funksionon një bashkëpunim i vazhdueshëm institucional ndërmjet aktorëve të përfshirë në proces: FSHZH, donatorëve, supervizorit, kontraktorit dhe njësive të qeverisjes vendore duke realizuar ndërveprimin reciprok në zbatimin e projekteve brenda afateve, kostove dhe cilësisë së parashikuar.
- Realizohet identifikimi, vlerësimi dhe menaxhimi i risqeve për çdo projekt/program dhe fazë të ciklit të tij.

Përveç sa më sipër, në misionet e auditimit janë konstatuar mangësi apo pamjaftueshmëri të sistemit të menaxhimit e kontrollit të brendshëm në disa pjesë të veçanta të tij. Në analizën e gjetjeve, njësia ka vlerësuar riskun dhe impaktet e tyre në arritjen e objektivave; Kështu, është konstatuar se:

- Në auditimin e fazës së projektimit, konstatohen raste me mangësi në projektet teknike, të cilët jo gjithmonë parashikojnë sinjalistikën e duhur në disa segmente kyçe me risk për sigurinë rrugore. Ky element duke u bashkangjitur edhe me problematikat e mirëmbajtjes së investimit të bërë (dëmtime, vjedhje të sinjalistikës apo mbrojtëseve anësore), riskon sigurinë e qarkullimit në rrugë.

- Studimet gjeologjike janë të fragmentuara, jo të thelluara dhe disa herë dhe të pasakta duke vështirësuar parashikimin e planeve të sistemimit të rrëshqitjeve. Kjo mangësi e konstatuar vlerësohet të sjellë riskun e qëndrueshmërisë së investimit të bërë si pasojë e rrëshqitjeve në seksione të ndryshme të rrugës.
- Konstatohen vonesa në nxjerrjen e lejeve të ndërtimit për nënprojektet e reja, ose probleme sociale të pasistemuara në fazat paraprake, të cilat riskojnë vonesa në fazat e mëtejshme të realizimit të nënprojektit.
- Në fazën e zbatimit teknik të projekteve konstatohen vonesa në grafikët e punimeve në terren, raste të përdorimit të materialeve jo në cilësinë e kërkuar të projektit teknik apo moszbatim i standardeve teknike gjatë punimeve, të cilat riskojnë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e investimit.
- Lidhur me Programin e Ujësullësave Rural (PUR) konstatohet performancë dhe ecuri e mirë në ndërtimin e skemave të ujësullësave, por vlerësohet si risk i konsiderueshëm garantimi i dy indikatorëve të programit: licencim/tarifimit dhe mirëmbajtja e sistemeve të ujësullësave të ndërtuar. Njësia përkatëse e ka të identifikuar dhe vlerësuar këtë risk që lidhet me problematikat ligjore dhe administrative apo praktikën e munguar të NJQV në këtë proces dhe është në ndjekje të procesit, i cili tashmë po hyn në këtë fazë të rëndësishme të tij.

Për të gjitha mangësitë dhe gjetjet e auditimit, gjatë vitit janë dhënë 59 rekomandime, të cilat janë aprovuar nga Drejtori Ekzekutiv dhe janë mbështetur me urdhra të brendshëm që garantojnë zbatimin e rekomandimeve për secilin auditim.

Gjatë vitit janë realizuar 5 raporte auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve në të cilat është konstatuar impenjim i plotë i strukturave për korrigjimin e mangësive të konstatuara dhe konsolidimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Është konstatuar se nga rekomandimet e dhëna, 62.5% e tyre janë realizuar dhe 37.5 janë në proces realizimi.

#### 4.5 Misione të Donatorëve

- **Mision i Bankës Botërore në kuadër të projektit “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”.**

Një mision i Bankës Botërore vizitoi Shqipërinë në muajin prill 2013, për të kryer vlerësimin e ecurisë së Projektit “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”. Objektivat kryesore të misionit ishin:

- (i) Arritja e objektivave dhe indikatorëve të performacës;
- (ii) Statusi i komponentëve të projektit;
- (iii) Konfirmimi i zbatimit të kënaqshëm të masave sociale dhe mjedisore;
- (iv) Impakti mjedisor dhe social – ekonomik;
- (v) Diskutim mbi përgatitjen dhe hartimin raportit përfundimtar (ICR);

Misioni konstatoi një ecuri të kënaqshme të projektit si edhe përputhshmëri në lidhje me planin e punës.

- **Misione të Bankës Gjermane për Zhvillim KfW në kuadër të Projekteve RWS III dhe SIF IV, për komponentin e Ujësjetësive Rurale dhe komponentin e Rrugëve Dytësore dhe Lokale.**

Misioni i parë është kryer gjatë periudhës nga 8 - 17 prill 2013.

Misioni i dytë është kryer gjatë periudhës nga 1 - 4 korrik 2013

Misioni i tretë është kryer në shtator 2013

Qëllimi i këtyre misioneve ka qenë vlerësimi i Programit të Ujësjetësive Rural RWSP I, II & III, por edhe komponenti i rrugëve dytësore dhe lokale në kuadër të projektit SIF IV. Gjatë këtyre misioneve u organizuan takime me FSHZH, me përfaqësues të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministrisë së Ekonomisë. Njëkohësisht janë organizuar vizita në terren për të parë nga afër ecurinë e deritanishme të projekteve në zbatim por edhe mundësinë e financimit të projekteve të reja si në kuadër të projektit të ujësjetësive ashtu edhe në kuadër të komponentit të rrugëve dytësore dhe lokale.

Misionet në fjalë vlerësuan mjaft pozitivisht progresin e bërë nga projektet duke theksuar se janë realizuar më së miri objektivat për të cilat ato janë financuar.

- **Misioni i Bankës Europiane të Investimeve (EIB), në kuadër të projektit “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”**

Një mision vlerësimi nga Banka Europiane e Investimeve vizitoi Shqipërinë gjatë periudhës 17 – 19 korrik 2013. Objektivi i misionit ishte vlerësimi i projektit për financimet e kryera nga EIB, ecuria e projektit, statusi i nënprojekteve, aspektet teknike dhe menaxheriale. Gjatë këtij misioni u zhvilluan një sërë takimesh me përfaqësues të FSHZH, kontraktorë, supervisorë. Njëkohësisht u zhvilluan dhe vizita në terren.

Në fund të këtij misioni u vlerësua se projekti vijon të ketë një ecuri shumë të mirë në zbatimin e tij. Rezultatet e arritura deri tani janë mjaft të kënaqshme dhe parashikohet që projekti të përfundojë në kohë.



## 5. AKTIVITETE TE TJERA

### 5.1 Përgatitja dhe aplikimi për projekte të reja

Një nga aktivitetet e rëndësishme e zhvilluar paralelisht me punën për zbatimin e projekteve të investimeve është dhe vlerësimi i nevojave dhe përgatitja e projekteve të reja, aplikimi pranë donatorëve dhe sigurimi i fondeve për financim. Gjatë vitit 2013 u përgatiten dhe u dorëzuan 4 projekte ndërkufitare (IPA), nga të cilat janë fituar 3; ku 2 prej tyre kanë filluar nga puna. Gjithashtu në bashkëpunim me Qeverinë Shqiptare, NJQV-të, dhe deputetë të Qarkut Vlorë ka filluar puna për hartimin e Programit të Investimeve Kapitale të Bregdetit të Jugut.

### 5.2 Projekte të bashkëfinancuara nga Bashkimi European në kuadër të Programit IPA

#### 5.2.1 IPA 2012 – Përmirësimi i aksesit në shërbimet publike për grupet vulnerable në zonat periferike në qytetet Tiranë dhe Durrës

Shuma e financimit është 8 milion € nga të cilat 6.2 financim i IPA kurse 1.8 milion € është financim i dy bashkive të Tiranës dhe Durrësit.

Objektivi specifik i këtij projekti është përmirësimi i infrastrukturës sociale për grupet me vulnerabël në qytetet e Tiranës dhe Durrësit.

Në bashkinë e Durrësit, në zonën e ish-kënetës do të ndërtohet një çerdhe dhe një kopësht e cila do të ketë një kapacitet për 150 fëmijë. Po kështu do të ndërtohen sipas standardeve edhe rrugët dhe trotualet që të çojnë në këtë çerdhe, kopësht.

Për sa i përket zonës periferike të Tiranës do të ndërtohet 1 çerdhe, një kopësht dhe një shkollë 9-vjeçare duke respektuar standardet bashkëkohore. Po kështu do të ndërtohet edhe një qendër sociale shumëfunktionale, si dhe do të ndërtohet infrastruktura e brendshme e këtij blloku banimi (rreth 18 rrugë të brendshme dhe trotuare).

Koha e realizimit të këtij projekti është 2014 – 2016.

#### 5.2.2 IPA 2013 – Përmirësimi i rrugëve dhe sistemit të furnizimit me ujë në zonat rurale

Objektivi specifik i këtij projekti është të përmirësojë kushtet e jetesës të banorëve në zonat rurale dhe të mbështesë zhvillimin ekonomik të këtyre zonave. E gjithë kjo do të mundësohet nëpërmjet ndërhyrjeve në shkallë të mesme dhe të vogël në ndërtimin e sistemeve të furnizimit me ujë. Financues të këtij programi do të jenë KfW me 25.4 milionë Euro dhe Bashkimi European përmes IPA 2013, me 9.8 milionë Euro.

Projekti është parashikuar të zgjasë nga 2014 deri në 2019. Pjesa e financimit për ndërtimin e rrugëve do të përfundojë në vitin 2016 kurse pjesa e ndërhyrjes në ndërtimin e ujësjellësave rurale do të vazhdojë deri në 2019.

Njëkohësisht në vijim të hartimit dhe zbatimit të programeve për ujësjellës, është siguruar një financim nga WBIF në shumën 750,000 Euro, të cilat do të përdoren për hartimin e fizibiliteteve teknike dhe sociale në kuadër të Programit të Ujësjellësave Rurale III, i cili parashikohet të ketë shtrirje në të gjithë vendin.

#### 5.2.3 IPATECH - Teknologji në miniaturë: sinergjia e kërkimeve dhe risive për të përmirësuar zhvillimin ekonomik të Adriatikut

Projekti zhvillohet në kuadrin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA Adriatik. Marrin pjesë 9 organizata nga 5 vende pjesëmarrëse (Shqipëri, Bosnjë, Greqi, Itali,

Kroaci). Buxheti total i projektit është 1,748,550 Euro. Kohëzgjatja e projektit është 30 muaj ku data e fillimi është me 1 tetor 2012 dhe ajo e përfundimit në mars 2015. Buxheti i llogaritur për FSHZH është 167,400 Euro.

Projekti ka si qëllim krijimin e një rrjeti bashkëpunimi midis organizatave publike dhe private në shtetet pjesëmarrëse duke stimuluar shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencave në kërkimet dhe inovacionet në sektorin agroushqimor. Gjatë kësaj periudhe është punuar dhe janë realizuar aktivitetet e pjesës së parë të projektit:

- Analize mbi sektorin agroushqimor ne Qarkun e Tiranës dhe drejtimet kryesore ku fokusohet ky sektor;
- Eshtë hartuar raporti mbi teknologjite e përdorura;
- Evidentimi i praktikave me të mira;
- përgatitja e një gazete elektronike në bashkëpunim me organizatën tjetër partnere shqiptare;

Brenda këtij kuadri është marrë pjesë në të tre takimet e organizuara nga partnerët e projektit ku është diskutuar mbi rezultatet e arritura, vështirësitë dhe mangësitë e hasura, problemet financiare dhe të raportimit si dhe janë përcaktuar aktivitetet që do të zbatohen në të ardhmen.

#### **5.2.4 Projekti MONTEAL**

Projekti MONTEAL synon të investojë në zhvillimin e qëndrueshëm njerëzor dhe ekonomik nëpërmjet menaxhimit me pjesëmarrje të turizmit në zonën ndërkufitare të rajoneve Kelmend, Shkrel, Andrijevicë, Berane dhe Plavë. FSHZH është i angazhuar në rolin e aplikantit lider dhe organizata partnere në Malin e Zi është Regional Tourism Organization-Bjelasica dhe Rajoni i Komovit.

Buxheti total i projektit është € 480,167.11, ku pjesa që do të menaxhohet nga FSHZH përfshin € 248,495.11.

Objektivi specifik i projektit është zgjerimi i potencialeve të rritjes dhe prosperitetit për rajonet e Kelmendit, Shkrelit, Plavës, Andrijevicës dhe Beranes nëpërmjet diversifikimit të ekonomisë së tyre lokale dhe zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm. Kjo do të arrihet kryesisht nëpërmjet krijimit të një platforme institucionale ndërkufitare për menaxhimin e potencialeve turistike, ndërtimeve të vogla infrastrukturore në miqësi me ambientin, ndërtimit të kapaciteteve, krijimit të ofertave të përbashkëta turistike, etj. Në këtë angazhim FSHZH do të bashkëpunojë ngushtë me komunën e Kelmendit dhe Shkrelit, si dhe me VIS Albania si partner lokal të projektit. Kohëzgjatja e projektit është 16 muaj.

#### **5.2.5 Projekti HERA**

HERA është akronimi i projektit të financuar nga programi IPA Adriatik të titulluar "Menaxhimi i qëndrueshëm i turizmit të trashëgimisë kulturore".

Projekti ka si qëllim të promovojë dhe vlerësojë trashëgiminë kulturore në vendet e Adriatikut, duke përmirësuar menaxhimin dhe promovimin e përfshirjes së komuniteteve lokale.

Projekti HERA konsiston midis të tjerave në realizimin e projekteve pilot dhe promovimin e Qendrës Multimediale të vizitorëve në "Fototekën Marubi" në qytetin e Shkodrës, si një nga institucionet me vlera më të mëdha kulturore, turistike dhe historike në Shqipëri.

Pushteti vendor në Shkodër ka ofruar një godinë të vendosur pranë zonës pedonale për

vendosjen e fototekës Marubi. Kjo godinë do të rikonstruktohet, kryesisht në ambientet e brendshme duke krijuar një strukturë të përshtatshme për ruajtjen dhe ekspozimin e kësaj arkive fotografike.

Ndërhyrja do të pasurohet edhe me pajisje multimediale të cilat do të ofrojnë përveç të tjerave mundësi për t'u njohur me itinerare interesante turistike të vendeve të tjera pjesmarrëse në projekt.

### **5.3 Programi i Investimeve Kapitale në Bregdetin e Jugut**

Përpjekje dhe aktivitete strategjike janë ndërmarrë nga FSHZH edhe për të harmonizuar rolin dhe aktivitetin e institucionit me programin e Qeverisë së re. Gjatë muajit dhjetor 2013, FSHZH në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave dhe Deputetë të Qarkut Vlorë u organizua Konferenca mbi "Programin e Investimeve Kapitale në Bregdetin e Jugut". Ky Program Investimesh përfshin Programin e Rrugëve Rurale, Programin e Rrugëve Urbane, Programin e Ujësjellës-Kanalizimeve si dhe Programin e Rikualifikimit Urban.

### **5.4 Ndërtimi i kapaciteteve të NJQV-ve**

Departamenti i Zhvillimit Rajonal (DZHR) gjatë vitit 2013 ka vazhduar angazhimin e vet për përbushjen e detyrave në bashkëpunim të ngushtë me njësitë e tjera të FSHZH-së si dhe ka çuar më tej punën për mbështetjen e njësive të qeverisjes vendore dhe harmonizimin me programin e Qeverisë së re. Bazuar në bindjen se FSHZH ka gjithë kapacitetet e nevojshme për një rol më të rëndësishëm në zhvillimin rajonal në vend ka qenë në qendër të vëmendjes dhe përpjekjeve të DZHR orientimi i institucionit drejt Zhvillimit Rajonal që harmonizon prioritet kombëtare me nevojat rajonale duke u kujdesuar njëkohësisht për rritjen e efikasitetit dhe besueshmërisë së njësive të qeverisjes vendore në marrëdhëniet me qeverinë dhe donatorët.

Gjatë muajve janar dhe shkurt një ekip i DZHR zhvilloi një seri takimesh në njësitë e zhvillimit rajonal në gjithë Këshillat e Qarqeve në vend me qëllim njohjen e eksperiencave dhe kapaciteteve ekzistuese, identifikimin e nevojave dhe të mundësive për bashkëpunim. Këto takime arritën në përfundimin se këto njësi, pavarësisht specifikave që hasen, ballafaqohen me problematika të ngjashme për të cilat një bashkërendim më i mirë i punës në nivel kombëtar do të ishte një kontribut i rëndësishëm për adresimin e nevojave të komunitetit si dhe për rritjen e rolit të këtyre njësive në kontekstin e zhvillimit rajonal. Aktiviteti konkludoi në muajin mars, në datat 12 dhe 13, kur u zhvillua takimi "Ndarja e përvojave të zhvillimit rajonal". Takimi që pati pjesmarrjen e drejtuesve të njësive të zhvillimit rajonal në Këshillat e Qarqeve në gjithë vendin i shërbeu rritjes së kapaciteteve të pjesmarrësve si dhe hodhi bazat për një bashkëpunim të vazhdueshëm. Prezantimi i eksperiencave të suksesshme nga disa qarqe si dhe informimi i ofruar prej specialistëve që mbulojnë tematika të zhvillimit rajonal në Këshillin e Ministrave (DEBASKON) dhe në Ministrinë e Integritimit Evropian i dhanë këtij aktiviteti konkretësi dhe dobi, që u vlerësuan nga pjesëmarrësit.

Në muajt shkurt dhe mars Qendra Burimore e Zhvillimit Rajonal dhe Lokal ofroi dy trajnime me tematikë "Gjenerimi dhe Menaxhimi i Projekteve në Nivel Vendor dhe Rajonal". Trajnimi i ofruar në datat 27 shkurt – 1 mars pati pjesmarrjen e punonjësve të njësive të zhvillimit rajonal në këshillat e qarqeve dhe disa prej bashkive të vendit, ndërsa në trajnimin me të njëjtën tematikë zhvilluar në datat 26 – 28 mars morën pjesë

punonjës prej disa komunash dhe bashkish të vogla në vend. Trajnimet ofruan një gamë informacionesh të vlefshme teorike dhe praktike në gjetjen dhe adresimin e donatorëve, përgatitjen e aplikimeve si dhe planifikimin e punës për një zbatim sa më efikas të projektit.

Ndërsa në muajin maj, Qendra Burimore e Zhvillimit Rajonal dhe Lokal zhvilloi kursin tre ditor të trajnimit Planifikimi Strategjik me Pjesëmarrje, tematikë që ka patur gjithnjë interes të madh nga njësitë vendore. Trajnimi u zhvillua në datat 22-24 maj dhe në të morën pjesë rreth 25 punonjës të Këshillave të Qarqeve, bashkive dhe komunave.

## 6. ANEKSE

- 6.1 Informacion mbi nënprojektet e programit “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”, financuar nga Banka Botërore;
- 6.2 Informacion mbi nënprojektet e programit “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”, financuar nga OFID;
- 6.3 Informacion mbi nënprojektet e programit “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”, financuar nga Banka e Këshillit të Evropës;
- 6.4 Informacion mbi nënprojektet e programit “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”, financuar nga IPA 2008;
- 6.5 Informacion mbi nënprojektet e programit “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”, financuar nga IDB;
- 6.6 Informacion mbi nënprojektet e programit “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”, financuar nga BERZH, BEI, IPA 2010 -2011;
- 6.7 Informacion mbi nënprojektet e programit “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale”, financuar nga KfW
- 6.8 Realizimi i zërave të buxhetit për vitin 2013;
- 6.9 Shpenzimet sipas Donatorëve dhe Kategorive për vitin 2013;
- 6.10 Rrugët Dytësore dhe Lokale të përfunduara deri më 31 dhjetor 2013;
- 6.11 Projekte në implementim në fund të vitit 2013;
- 6.12 Harta treguese e nënprojekteve në zbatim nga FSHZH deri në dhjetor 2013;

## 6.1 Informacion mbi nënprojektet e programit “Rrugët Dytësore & Lokale”, financuar nga Banka Botërore & GoA (IDA) (Dhjetor 2013)

Nr.	Qarku	Rrethi	NJQV	Emri i nënprojektit	Donatori	Gjatësia (km)	Data e fillimit	Data e mbarimit	Statusi	Realizimi teknik %	Realizimi financiar %
1	DIBËR	DIBËR	F.CIDHEN, SLLOVE, KALA E DODËS	Rikonstruksioni i rrugës “Kuben-Perroi I Kapsit” (9.8 Km)	IDA SLRP & GoA (SLRP)	9.8	27-nentor-08	30-shtator-10	Mbyllur Dorezuar ARSH-se	100	100
2	DURRËS	DURRËS	ISHËM	Asfaltimi i rrugës “ Shetaj - Kisha e Skenderbeut” ( 4.5 km)	IDA SLRP & GoA (SLRP)	4.5	14-qershor-13	14-gusht-13	Garanci	100	100
3	FIER	FIER	B.FIER, KUMAN, ZHARRËZ	Rikonstruksioni i rrugës “Strum-Qafa e Marinzes” (12.6 Km)	IDA SLRP & GoA (SLRP)	12.6	27-nentor-08	16-janar-10	Mbyllur Dorezuar ARSH-se	100	100
4	KUKËS	KUKËS	SHTIQEN, BICAJ	Vendosje parrakësh mbrojtës në rrugën " Aeroport - Bicaj - Qafa e Kolosjanit "	IDA SLRP & GoA (SLRP)		7-qershor-13	25-qershor-13	Garanci	100	95
5	KUKËS	KUKËS	UJMISHT,BUSHTRICE,GRYKCAJ, KALIS	Rikonstruksioni i rrugës “Domaj-Ura e Lapajve” (11.5 Km)	IDA SLRP & GoA (SLRP)	11.5	27-nentor-08	20-shtator-11	Mbyllur Dorezuar ARSH-se	100	100
6	KUKËS	KUKËS	UJMISHT,BUSHTRICE,GRYKCAJ, KALIS	Rikonstruksioni i rrugës “Domaj-Ura e Lapajve” (Janë punime shtese në rrugën e re )	IDA SLRP & GoA (SLRP)		1-qershor-13	30-qershor-13	Garanci	100	99
7	LEZHË	LEZHË	DAJÇ	Rikonstruksioni i rrugës “Dajç – Dragushë” (4.9 km)	IDA SLRP & GoA (SLRP)	4.9	7-maj-13	1-korrik-13	Garanci	100	99
8	TIRANË	TIRANË	BALDUSHK	Rikonstruksioni i rrugës “Ura e Farkes - Qender Fshat” (6.6 Km)	IDA SLRP & GoA (SLRP)	6.6	25-nentor-08	25-mars-10	Mbyllur Dorezuar ARSH-se	100	100
9	TIRANË	TIRANË	VAQARR/ KASHAR	Ndriçimi i aksit kryesor të rrugës (Vaqarr) Prush - Gropaj - Kthesa e Kasharit	IDA SLRP & GoA (SLRP)		6-qershor-13	30-qershor-13	Garanci	100	0

49.9 km

## 6.2 Informacion mbi nënprojektet e programit “Rrugët Dytësore & Lokale”, financuar nga OFID I & II (Dhjetor 2013)

Nr	Qarku	Rrethi	NJQV	Emri i nënprojektit	Donatori	Gjatësia (km)	Data e fillimit	Data e mbarimit	Statusi	Realizimi teknik %	Realizimi financiar %
1	BERAT	BERAT	BERAT	Rikonstruksioni i rrugës së Goricës	OFID (OPEC) I (SLRP)	0.127			Tenderim		
2	BERAT	BERAT	VELABISHT, SINJË	Rikonstruksioni i rrugës “Ura e Gorices - F. Mbreshtan” (7.8 Km)	OFID (OPEC) I (SLRP)	7.8	24-qershor-09	15-prill-10	Mbyllur Dorezuar ARSH-se	100	100
3	BERAT	BERAT	VELABISHT, SINJË	Ndërtimi i urës së re të Velabishtit	OFID (OPEC) I (SLRP)	0.07	2-korrik-13	2-janar-14	Perfunduar	100	57
4	BERAT	BERAT	VELABISHT, SINJË	Rikonstruksioni i urës së vjetër të Velabishtit	OFID (OPEC) I (SLRP)	0.043			Tenderim		
5	ELBASAN	ELBASAN	BELSH, FIERZË	Rikonstruksioni i rrugës “Belsh – Fierze” (9.8 Km)	OFID (OPEC) I (SLRP)	9.8	15-prill-09	12-prill-10	Mbyllur Dorezuar ARSH-se	100	100
6	GJIROKASTËR	GJIROKASTËR	LUNXHERI	Rikonstruksioni i rrugës “Valare – Erind” (5.4 Km)	OFID (OPEC) I (SLRP)	5.4	23-qershor-09	23-prill-10	Mbyllur Dorezuar ARSH-se	100	95
7	KORCË	KORCË	VRESHTAS, POJAN	Rikonstruksioni i rrugës “Kryqezim Lapidar – Korite” (10.5 Km)	OFID (OPEC) I (SLRP)	10.5	14-prill-09	13-shkurt-10	Mbyllur Dorezuar ARSH-se	100	100
8	LEZHË	LEZHË	LEZHË, KOLSH, KALLMET	Rikonstruksioni i rrugës “LEZHË – Kallmet” (13.2 Km)	OFID (OPEC) I (SLRP)	13.2	13-prill-09	30-gusht-10	Mbyllur Dorezuar ARSH-se	100	100
9	LEZHË	LEZHË	LEZHË	Rikonstruksioni i urës n Lagjen Skenderbeg	OFID (OPEC) I (SLRP)	0.068			Tenderim		
10	SHKODËR	SHKODËR	VAU I DEJËS, HAJMEL	Rikonstruksioni i rrugës “Vau i Dejes – Nenshat” (11.8 Km)	OFID (OPEC) I (SLRP)	11.8	6-maj-09	25-shtator-10	Mbyllur Dorezuar ARSH-se	100	100
11	TIRANË	TIRANË	BALDUSHK	Rikonstruksioni i rrugës së Baldushkut (20 m)	OFID (OPEC) I (SLRP)	0.02	22-maj-12	22-nentor-12	Garanci	100	89
12	VLORË	SARANDË	XARRE, ALIKO	Rikonstruksioni i rrugës “Xarre - Fshati Pllake” (10.92 Km)	OFID (OPEC) I (SLRP)	10.9	15-prill-09	10-dhjetor-10	Mbyllur Dorezuar ARSH-se	100	100
13	DURRËS	DURRËS	GJEPALAJ, SHIJAK.	Rikonstruksioni i rrugës " Shijak - Gjepale" (6.3 km)	OFID (OPEC) II (SLRP)	6.3	11-prill-11	30-shtator-12	Garanci	100	89
14	DURRËS	KRUJË, KURBIN	THUMANË, LAC.	Rikonstruksioni i rrugës " Thumane - Lac " (10.54 km)	OFID (OPEC) II (SLRP)	10.54	1-prill-11	1-maj-14	Zbatim	80	67
15	ELBASAN	LIBRAZHD	HOTOLISHT	Rikonstruksioni i rrugës “Hotolisht – Frar” (6.2 km)	OFID (OPEC) II (SLRP)	6.2	15-shtator-11	15-shtator-12	Garanci	100	90

16	GJIROKASTËR	GJIROKASTËR	DROPULL I SIPËRM	Rikonstruksioni i rrugës "Llongo – Koshovice" (5.3 km)	OFID (OPEC) II (SLRP)	5.3	30-gusht-11	30-gusht-12	Garanci	100	89
17	KUKËS	TROPOJË	BUJAN	Rikonstruksioni i rrugës "Bajram Curri – Markaj" (3.85km)	OFID (OPEC) II (SLRP)	3.85	15-qershor-13	15-shkurt-14	Zbatim	59	38
18	LEZHË	LEZHË	SHENKOLL	Rikonstruksioni i rrugës "Shenkoll - Tale1 - Hidrovor"	OFID (OPEC) II (SLRP)	6.2	1-prill-11	31-korrik-12	Garanci	100	99
19	SHKODËR	SHKODËR, LEZHË	HAJMEL, DAJÇ	Rikonstruksioni i rrugës "Koter - Manastiri I Karmelitaneve" (4.15 km)	OFID (OPEC) II (SLRP)	4.15	14-dhjetor-11	14-dhjetor-12	Garanci	100	95
20	TIRANË	TIRANË	DAJT, TIRANE	Rikonstruksioni i rrugës së Qesarakes, Komuna Dajt (338 ml)	OFID (OPEC) II (SLRP)	0.33			Kontraktim		
21	VLORË	SARANDË	LUKOVË	Rikonstruksioni i rrugës Qazim Pali (2.02 km)	OFID (OPEC) II (SLRP)	2.02	25-qershor-13	15-prill-14	Zbatim	46	36
